VENDIM
Nr. 638, datë 31.7.2013

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 31.7.2012, PËR ANKIMET NR. 604/07, NR. 43628/07, NR. 46684/07 DHE NR. 34770/09, "MANUSHAQE PUTO DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË"

(Ndryshuar me VKM Nr. 747, datë 5.9.2013)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46 të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996 "Për ratifikimin e Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore", të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012 "Për buxhetin e vitit 2013", me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e pjesshëm të vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 31.7.2012, për ankimet nr. 604/07, nr. 43628/07, nr. 46684/07 dhe nr. 34770/09, "Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë", në masën 100 000 000 (njëqind milionë) lekë, si dhe pagesën e tatimit mbi të ardhurat për dëmshpërblimin.

2. Shuma e përcaktuar si detyrim në pikën 1 të paguhet menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe për të përllogaritur vlerën në euro të detyrimit të shlyer të mbahet në konsideratë kursi i këmbimit të bankës, ku është depozituar shuma, në datën e kryerjes së pagesës.

Pjesa e mbetur e detyrimit të përcaktuar në vendimin e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 31.7.2012, për ankimet nr. 604/07, nr. 43628/07, nr. 46684/07 dhe nr. 34770/09, "Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë", të paguhet sipas afateve të përcaktuara me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

Ministria e Financave të marrë masat e nevojshme për gjetjen e mundësisë financiare për ekzekutimin e pjesës së mbetur të detyrimit, brenda afateve sa më të shpejta. Ministria e Financave njofton Ministrinë e Drejtësisë për nisjen e procedurave për ekzekutimin e detyrimit në varësi të mundësisë financiare për përballimin e saj.

3. Shuma e përcaktuar si detyrim në pikën 1 të këtij vendimi, të depozitohet në njërën nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankuesve, në vlerë proporcionale me detyrimin që ka shteti shqiptar për secilin prej tyre, sipas vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 31.7.2012, për ankimet nr. 604/07, nr. 43628/07, nr. 46684/07 dhe nr. 34770/09, "Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë".

4. Pagimi i shumës së depozituar sipas pikës 3 të këtij vendimi, në favor të ankuesve, të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes të të gjithë dokumentacionit ligjor të nevojshëm për kryerjen e pagesave nga Buxheti i Shtetit.

5. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

6. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha